



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:068682

Datë: 01.02.2022

Numri i dokumentit: 02667758

P.nr.99/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.D, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.410-10/2020 të datës 01.06.2020 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik më datë 12.01.2022, në praninë e Prokurores së Shtetit Luljeta Bilalli të pandehurit dhe palës së dëmtuar F. A., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë **01.02.2022** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.D nga Kaçaniku rruga "...", i lindur më datë ..., nga i ati Rr... dhe e ëma B..., e gjinisë Sh..., i martuar, prind i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bukëpjekës në furrën "...” në Kaçanik, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.05.2020 rreth orës 20:05, në Kaçanik në rrugën "Ismael Raka", me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës F. A., në atë mënyrë që deri sa e dëmtuar ishte duke e përfunduar ndërrimin e punës, aty ku punonte në furrën e bukës, i pandehuri në cilësi të

menagjerit të kësaj furre, fillimisht i drejtohet me fjalët se duhesh ti pastrosh edhe dollapët e lokalit, e dëmtuara i' u ka përgjigjur se nëse mundem i pastroj sot e nëse jo i pastrojë nesër, pastaj i pandehuri e ka kapur për krahu të dëmtuarën duke e tërhequr zvarrë dhe e përplasur për dollapë të lokalit.

Me këtë veprime ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365 dhe 453 të KPPK-së e:

GJYKON

I. Dënim me gjobë në shumë nga 400€ (Katër qind euro), të cilën gjobë është e obliguar që ta paguaj në 4 këste mujore të barabarta, në afat prej 4 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar, nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

III. Detyrohet i pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën nga 40.00€, dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.410-10/2020 të datës 01.06.2020 kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 12.01.2022.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ka theksuar se është penduar për rastin e ndodhur, dhe ka premtuar se nuk do të përsëris veprime të njëjta në të ardhmen.

Prokurorja e Shtetit duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform nenit 248 të KPP-së dhe i ka propozuar gjykatës që pandehurit të i shpall fajtorë dhe t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

Pala e dëmtuar ka deklaruar i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, dhe për të pandehurin gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, se është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale dhe është hera e

parë që ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës, (për ekspertizën mjeko ligjore të palës së dëmtuar) shumë prej 20€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumë nga 20.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumë prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.99/20 datë 01.02.2022

Procesmbajtësja

Suzane Rudi

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.